



VENDIM MBI PAPRANUESHMËRI

Data e miratimit: 21 prill 2015

Numri i lëndës: 2014-33

Arben Krasniqi

kundër

EULEX-it

Paneli për Shqyrtimin e të Drejtave të Njeriut i mbledhur me 21 prill 2015, ku të pranishëm ishin anëtarët e paraqitur në vijim:

Znj. Magda MIERZEWSKA, kryesuese
Z. Guénaël METTRAUX, anëtar
Znj. Katja DOMINIK, anëtare

Ndihmuar nga
Z. John J. Ryan, zyrtar i lartë ligjor
Znj. Joanna MARSZALIK, zyrtare ligjore

Pas shqyrtimit të ankesës së lartpërmendur, e cila është dorëzuar në përputhje me Veprimin e Përbashkët të Këshillit 2008/124/CFSP të datës 4 shkurt 2008, Konceptin Llogaridhënës të EULEX-it të datës 29 tetor 2009 për themelimin e Panelit për Shqyrtimin e të Drejtave të Njeriut dhe rregullores së punës së Panelit siç është ndryshuar së fundi më 15 janar 2013,

Pas shqyrtimit, u vendos si në vijim:

I. PROCEDURAT PRANË PANELIT

1. Ankesa është regjistruar më 24 qershor 2014.

II. FAKTET

2. Më 6 mars 2013, prokurori special i EULEX-it ka nisur një hetim ndaj ankuesit mbi dyshimin për krim të organizuar, zhvatje dhe posedim të paautorizuar të armëve. Ankuesi ishte paraburgosur më 28 tetor 2013.
3. Më 20 nëntor 2013, avokati i ankuesit i ka kërkuar prokurorit t'i ofroj qasje në dosjen e lëndës dhe të ftohet në çdo intervistë të dëshmitarëve dhe të të pandehurve.
4. Më 28 Nëntor 2013, prokurori është pajtuar që avokati mbrojtës duhet të kenë qasje në dosjen e lëndës për aq sa lejon neni 213 par. 3 nga Kodi i Procedurës Penale (KPPK). Prandaj, ai mund të konsultohet me procesverbalet e marrjes në pyetje të të pandehurit, materialet e marra nga i pandehuri apo që i përkasin të pandehurit, materialet lidhur me veprimet e tilla hetimore në të cilat ai ka qenë i pranishëm ose duhet të ishin pranuar si dhe analizat e ekspertëve. Megjithatë, ishte vendosur që ai nuk do të ketë qasje në materiale të tjera të dosjes së lëndës. Prokurori është mbështetur në par. 6 të nenit 213 të KPPK-së, sipas të cilit prokurori mund t'ia refuzoj mbrojtjes qasjen në gjërave të caktuara në dosjen e lëndës nëse ekziston ndonjë probabilitet se ajo mund të rrezikojë qëllimin e hetimit, jetën apo shëndetin e njerëzve.
5. Më 10 Janar 2014 avokati i ankuesit ka parashtruar një kërkesë për të pasur qasje të plotë në tërë dosjen e lëndës në Gjykatën Themelore të Prishtinës. Përndryshe, ai ka kërkuar që të ketë qasje në të gjitha dokumentet që nuk përmbajnë informata konfidenciale apo qasje në një version të redaktuar të dosjes së plotë të lëndës. Përgjigja e prokurorit ishte parashtruar në Gjykatën Themelore më 14 janar 2014.
6. Më 20 Janar 2014, një gjykatës i procedurës paraprake i Gjykatës Themelore ka refuzuar kërkesën. Gjykata ka gjetur se avokatit të ankuesit i ishte lejuar qasja në dosjen e lëndës në përputhje me nenin 213 par. 3 të KPPK-së. Është përsëritur se neni 213 par. 6 i KPPK-së ka paraparë mundësinë e mohimit të qasjes së mbrojtjes në pjesë të caktuara të dosjes së lëndës për arsye të saktësuara aty. Gjykata ka konsideruar se të drejtat e ankuesit nuk ishin shkelur duke ia mohuar atij qasjen në deklaratat e dëshmitarëve dhe aktvendimin për fillimin e hetimeve, pasi këto iu ishin nënshtruar masave mbrojtëse të urdhëruara nga gjykata. Lejimi i qasjes së ankuesit në ato dokumente do të binte në kundërshtim me ato masa mbrojtëse. Gjykata më tej ka konstatuar se në atë fazë të procedurës, duke i ofruar mbrojtjes versionin e redaktuar të dëshmitarëve të mbrojtur do ta rrezikonte qëllimin e hetimit, jetën ose shëndetin e njerëzve. Gjykata ka konstatuar se në mes të balancimit të të drejtave të mbrojtjes dhe rrezikut potencial për jetën ose shëndetin e personave nën masat mbrojtëse, kjo e fundit duhet të mbizotërojë.

7. Më 19 shkurt 2014, ankuesi ka parashtuar një ankesë pranë Gjykatës Kushtetuese të Kosovës. Ai ka kërkuar nga gjykata që të detyrojë gjykatësin e procedurës paraprake t'i ofrojë atij qasje të plotë në dosjen e lëndës.
8. Më 31 mars 2014 Gjykata Kushtetuese ka gjetur kërkesën e ankuesit të papranueshme.

III. ANKESAT

9. Ankuesi thirret në nenin 5 (e drejta për liri) dhe nenin 6 (e drejta për gjykim të drejtë) të Konventës Evropiane të të Drejtave të Njeriut dhe Lirive Themelore (Konventa). Ai ankohet se pa pasur njohuri të plotë rreh dosjes së lëndës, nuk është në gjendje ta kundërshtoj ligjshmërinë e paraburgimit të tij. Për më tepër, ai pohon se parimi i gjyimit të drejtë dhe i barazisë në proces e bën të nevojshme që ai duhet të ketë në dispozicion të tij të njëjtin informacion ashtu si edhe prokuroria.

IV. LIGJI

10. Paneli do të shqyrtojë lëndën sipas nenin 5 par. 4 të Konventës.
11. Si çështje e së drejtës materiale, Paneli është i autorizuar për të përdorur instrumentet e të drejtave të njeriut siç pasqyrohen në konceptin llogaridhënës të EULEX-it të datës 29 tetor 2009 mbi themelimin e Panelit për Shqyrtimin e të Drejtave të Njeriut. Me rëndësi të veçantë për punën e Panelit janë Konventa Evropiane për Mbrojtjen e të Drejtave të Njeriut dhe Lirive Themelore (Konventa) dhe Konventa Ndërkombëtare mbi të Drejtat Civile dhe Politike, të cilat përcaktojnë standardet minimale për mbrojtjen e të drejtave të njeriut, të cilat duhet të garantohen nga autoritetet publike në të gjitha sistemet ligjore demokratike.
12. Sipas praktikës së vendosur të gjykatës evropiane të të drejtave të njeriut, procedurat e zhvilluara sipas nenit 5 § 4 të Konventës para një gjykate që shqyrton një ankesë rreth paraburgimit duhet të jenë kundërshtuese. Ato duhet gjithmonë të sigurojnë "barazinë në proces" midis palëve, prokurorit dhe personit të ndaluar. Barazia në proces nuk është e siguar nëse aplikantit ose mbrojtësit të tij i është mohuar qasja në këto dokumente në dosjen hetimore, të cilat janë thelbësore që në mënyrë efektive të kundërshtohet ligjshmëria e paraburgimit të tij (midis autoriteteve të tjera shih *Mooren kundër Gjermanisë* [GC.], nr. 11364/03, § 124, 9 korrik 2009; *Svipsta kundër Letoninë*, nr. 66820/01, § 129, KEDNj 2006 III (ekstrakte); *Schöps kundër Gjermanisë*, nr. 25116/94, § 44, KEDNj 2001-I; dhe *Garcia Alva kundër Gjermanisë*, nr. 23541/94, § 39, 13 shkurt 2001). Çdo kufizim mbi të drejtën e të paraburgosurit ose përfaqësuesit të tij në qasjen në dokumentet e dosjes së lëndës që formojnë bazën e

lëndës së prokurorit kundër tij duhet të jetë tepër i nevojshme duke u bazuar në një interes kundërbalancues publik. Aty ku nuk është e mundur zbulimi i plotë, neni 5 § 4 kërkon që vështirësitë që i shkakton kjo të jenë të balancuara në atë mënyrë që personi ende të ketë mundësi që në mënyrë efektive t'i kundërshtoj akuzat ndaj tij (shih *Piechowicz kundër Polonisë*, nr. 20071/07, § 203, 17 prill 2012, duke ju referuar më tej *A. dhe të Tjerët kundër Mbretërisë së Bashkuar* [GC], nr. 3455/05, § 205, KEDNj 2009).

13. Megjithatë, para se të merret parasysh ankesa mbi bazueshmërinë e saj, Paneli duhet të vendosë nëse do ta pranoj ankesën, duke marrë parasysh kriteret e pranueshmërisë të përcaktuara me rregullën 29 të rregullores së vet të punës.
14. Sipas rregullës 25, paragrafi 1, të rregullores së punës, Paneli mund të shqyrtojë ankesat lidhur me shkeljet e të drejtave të njeriut nga ana e EULEX-it Kosovë gjatë ushtrimit të mandatit të tij ekzekutiv në drejtësi, polici dhe dogana.
15. Paneli tashmë ka konstatuar në shumë raste se veprimet e prokurorëve të EULEX-it të marra në kuadër të hetimit penal janë pjesë e mandatit ekzekutiv të EULEX-it në Kosovë dhe për këtë arsye bien në kuadër të mandatit të Panelit (shih, për shembull *E kundër EULEX-it*, 2012-17, 30 gusht 2013, § 20; *Z kundër EULEX-it*, 2012-06, më 10 prill 2013 § 32; *W kundër EULEX-it*, 2011-07, 5 tetor 2012 § 21).
16. Për më tepër, veprimet apo mosveprimet nga prokurorët e EULEX-it gjatë fazës hetimore të procedurës penale në parim nuk duhet të konsiderohen se janë pjesë e “procedurave gjyqësore” për përcaktimin e kompetencës së Panelit (shih *Thaqi kundër EULEX-it*, 2010-02, 14 shtator 2011, § 64). Në këtë aspekt, Paneli ka konstatuar se “veprimet dhe mosveprimet e prokurorëve të EULEX-it [...] para dorëzimit të padisë mund të bien në kuadër të mandatit ekzekutiv të EULEX-it” (shih *Thaqi*, i cituar më lartë, § 93).
17. Për më tepër, nuk mund të përjashtohet që Paneli të mund të jetë kompetent për të vlerësuar veprimet e prokurorëve të EULEX-it në hetimet penale edhe nëse ata i nënshtrohen shqyrtimit gjyqësor. Paneli do të ishte kompetente për të shqyrtuar këto akte dhe vendime, për shembull ku subjekti i akteve dhe vendimeve që i nënshtrohen rishikimit të tillë prek çështjet e të drejtave të njeriut, për shembull të drejtën për liri ose të drejtën për gjykim të drejtë. Paneli do të ndërhyjë vetëm atëherë nëse ose kur akuzat e shkeljeve të të drejtave të njeriut që i atribuohet prokurorit nuk janë adresuar plotësisht nga autoritetet kompetente gjyqësore (shih *E kundër EULEX-it*, cituar më lartë, § 22; *Z kundër EULEX-it*, cituar më lartë, § 34).
18. Në lidhje me rastin në fjalë, Paneli konstaton se ankuesi kundërshton vendimet e dhëna nga Gjykata Themelore e Prishtinës dhe Gjykata

Kushtetuese në lidhje me qasjen në dosjen e lëndës së tij të përpiluar nga prokuroria dhe pajtueshmërinë e këtyre vendimeve me të drejtat përkatëse të standardeve të të drejtave të njeriut, posaçërisht garantitë procedurale të së drejtës për liri të garantuara me nenet 5 par. 4 të Konventës.

19. Paneli konstaton se të gjitha vendimet lidhur me dosjen e lëndës së ankuesit ishin dhënë nga autoritetet kompetente gjyqësore me kërkesën e tij. Gjykatave ju është dhënë një mundësi për të shqyrtuar plotësisht edhe argumentet e ankuesit dhe të prokurorit. Ankuesi nuk ka identifikuar ndonjë çështje të të drejtave të njeriut që nuk ka qenë në gjendje ta ngritë në gjykatë apo se gjykata nuk ka arritur të adresojë siç duhet (shih me ndryshimet e nevojshme (*mutatis mutandis*) *E kundër EULEX-it*, cituar më lartë, § 24; *Z kundër EULEX-it*, cituar më lartë, § 34).
20. Paneli në shumë raste ka konstatuar se, sipas rregullës 25, paragrafit 1 të rregullores së punës, bazuar në konceptin e llogaridhënies së OPLAN-it të EULEX-it në Kosovë, nuk ka kompetencë mbi aspektet administrative e as aspektet juridike të punës së gjykatave të Kosovës. Fakti se gjykatësit e EULEX-it ulen në trupin gjykues të ndonjë gjykate të caktuar, nuk do të thotë se ia humb asaj gjykate karakterin e të qenit pjesë e sistemit juridik të Kosovës (shih ndër të tjera *Rifat Kadribasic kundër EULEX-it*, nr. 2014-09, i 10 nëntorit 2014 § 11, *Shaban Kadriu kundër EULEX-it*, 2013-27 27 maj 2014 § 17).
21. Rrjedhimisht, duke pasur parasysh faktin se kërkesa e ankuesit që t'i ofrohej qasja në dosjen e tij është shqyrtuar plotësisht nga gjykatat, Paneli nuk ka juridiksion për t'i shqyrtuar ankesat e tij.

PËR KËTO ARSYE,

Paneli njëzëri konstaton se nuk ka kompetencë për ta shqyrtuar këtë ankesë, pasi bie jashtë juridiksionit të tij në bazë të nenit 29 (d) të rregullores së vet të punës,

SHPLL ANKESËN TË PAPRANUESHME.

Për Panelin,

John J. RYAN
Zyrtar i lartë ligjor

Magda MIERZEWSKA
Kryesuese